



Raport vjetor 2018

QENDRA RINORE ARDHMËRIA – KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2018

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2018

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmëria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2018.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmëria-Klinëtë cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. KURSET E PËRDITSHME

2. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

3. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. KURSET E PËRDITSHME:

1.1 **Kurs I Gjuhës Angleze**, në menyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i gjuhës Angleze për fëmijë dhe të rinjë. Çdo ditë gjatë vitit këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e Gjuhës Angleze. Kurset e gjuhës Angleze për fëmijë gjatë vitit 2018 janë udhëhequr 6 muaj nga vullnetaret kosovare (Diellza Ferizi, Artiola Limani & Heloina Elezaj) ndersa Kursi për të rinjë mosha 14-18 Vjeq është është zhvilluar nga Vullnetarja amerikane (Peace Corps-Michaeala Washington). Secili grup i Gjuhës Angleze është zhvilluar 2 orë në javë (4 grupe) dhe ka zgjatur 3 muaj një nivel.

1.2 **Kursi Gjuhës Italiane** është realizuar 3 muaj, dhe nga ky aktivitet përfituan 1 grup i të rinjve, të cilët paten mundësi të mësojnë gjuhën Italiane nga vullnetari Italian nga organizata RTM, i cili me shumë përkushtim punoi dhe dha kontributin e tij tek rinia e Klinës.

1.4 **Workshoptet edukative me fëmijë** Gjatë 3 mujave janë zhvilluar puntori të rregullta kreative për fëmijë dhe kemi krijuar një ambient të sigurtë që ata mund të punojnë gjëra të ndryshme nga letrat e përdorura, qeset e plastikes etj. Në mënyrë që fëmijët të edukohen për të mbrojtur ambientin dhe për të kaluar një pjesë të tyre të edukimit në qender rinore se paku 2 orë në javë. Qëllimi i krijimit të kësaj puntorie dhe ndarja e kohës së veçant për fëmijë është edukimi për mbrojtjen e ambientit dhe reciklimin e mbeturinave nga vetë fëmijët. Kjo Puntori është përkrahur nga projekti "Mbrojtja e mjedisit".

2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

2.1 Vizitë një ditore në Bogë me grupin e vullnetareve të organizates, qëllimi i kësaj vizite është që të rinjtë të shijojnë bukurit natyrore të bjeshkëve të nëmura në menyrë që të motivojmë të rinjtë për të zhvilluar aktivitete grupore gjatë tërë vitit.

Zhvilluar me 4 Janar 2018

2.2 Edukimi Peer to Peer-Bashkëmohatar

Edukimi bashkëmohatar është udhëhequr nga vullnetarja lokale Diellza Ferizi e cila ka punuar më moshtaret e saj gjatë dy muajve dhe ka lehtësuar kapacitetet e tyre në gjuhën angleze, ajo ka arritur që t'ju ndohmojmë miqve të saj dhe të përmirsojnë notat në lëndën e gjuhës angleze.



2.3 Dita ditën Ndërkombëtare të ujit

Me 22 mars, në ditën Ndërkombëtare të ujit të rinjtë e qendres rinore Ardhmeria Klinë zhvilluan një workshop edukativ për fëmijë dhe të rinjë. Qëllimi i workshopit ishte që të të rinjtë të edukohen për mbrojtjen e lumenjëve dhe kursimit të ujit.



2.4 Dita e tokës-Global youth service day

Hulumtimi terrenit për gjëndjen e mjedisit në Klinë, Disa vullnetare të grupit Klina Youth Chapter vendosen që të bëjnë një hulumtim të terrenit për të shikuar dhe për të kuptuar se në çfarë gjëndje e kemi mjedisin në qytetin e Klinës. Grupi i vullnetareve fotografuan të gjitha mbeturinat që gjeten dhe të cilat gjenden në qender të qytetit. Duke u bazuar në këtë hulumtim dhe në bazë të reflektimit të grupit vërejtëm që mbeturinat janë zvogëluar në krahasim me vitin 2017, kjo vertetëson se gjëndja ka filluar të përmirsohet dhe ka ndryshime në Klinë, përveq parkut të Malishganit. Po ndajm me juve ca foto të terrenit. *Punuar me 10 prill 2018*




Takime dhe intervista për gjëndjen e mjedisit në Klinë: janë realizuar disa takime dhe intervista me qytetar, të Rinjë, Mirëmbajtës të banesave, Drejtori të shërbimeve publike, Zyrtar komunal dhe Kompanin Ambienti në Klinë.

Vullnetaret e grupit arritën që të organizojnë dhe realizojnë takime me përfaqësues kompetent dhe qytetar për të diskutuar së bashku për gjëndjen e mjedisit në Klinë, dhe të marrim informata adekuate nga personat kompetent për gjëndjen e mirëmbajtjes së mjedisit.

Të gjitha takimet dhe intervistat e bëra ishin shumë të mira dhe vullnetaret arritën të marrin informata të duhura rreth organizimit të mirëmbajtjes së mjedisit nga institucionet kompetente, vështërsitë dhe sfidat që kanë personat kompetent por gjithashtu edhe sjelljet dhe përgjegjësit tona si qytetar.

16 Prill 2018.



Fushatë vetëdijësuese për mjedisin

Pas punës së hulumtimve dhe takimeve të organizuara kemi arritur që të gjitha informacionet që kemi marrur nga tereni ti publikojm në një broshurë, në menyre që keto informata të arrijn edhe publikun. Janë shpërndarë 100 copë broshura nga të rinjtë e qendres rinore për të treguar gjëndjen aktuale të mjedisit në Klinë dhe dëmet që shkaktojnë mbeturinat. Ky aktivitet kishte për qëllim vetëdijësimin e qytetareve tonë për mbrojtje të mjedisit. Ky ishte aktiviteti I fundit I organizuar për global youth service day-Dita e Tokës.



2.4 Dita Evropes, 9 Maj.

Për të shënuar ditën e Evropës në Kosovë kemi vendosur që të zhvillojm një Fushatë Lobuese për liberalizimin e vizave për qytetaret e Kosovës. Fushata është zhvilluar nga të rinjtë e Klinës të cilët kanë përgaditur një video dhe është publikuar në youtube:
<https://www.youtube.com/watch?v=ruEY45i3Nde>, Kosovo youth needs Visa, 9 Maj 2018.

2.5 Dita ndërkombëtare e duhanit

Workshopi një ditor për të rinjë është organizuar në qender rinore me qëllim të parandalimit dhe të vetëdijësimit të të rinjve për pasojat e Duhanit. Sipas disa kërkimeve shkencore pirja e duhanit është një nga faktorët kryesorë të jetesës që ndikojnë në shëndetin e qenieve njerëzore. Jeta e gjatë e duhanpirësve ka një prevalencë më të lartë të sëmundjeve të përbashkëta, të tilla si arteriosklerozes dhe COPD me ndikim të madh sistemik dhe shumë sëmundjeve tjera.

Dy vullnetare përgaditen një program edukativ për të rinjtë e moshave 12-14 vjec në Klinë.



2.6 Programi veror 2018

Gjatë muajit Korrik qendra rinore ka organizuar një program veror për fëmijë dhe të rinjë në mënyrë që të zhvillojm kapacitetet dhe aftësit e të rinjve në aktivitete dhe në komunitet. Qëllimi i këtij programi është që të motivojm të rinjtë të punojn me fëmijë dhe njëkohësisht të zhvillojn aftësitë dhe kapacitet rinore në organizim, menaxhim dhe lidhshp.

Programi veror është zhvilluar gjatë muajit korrik dhe ka zgatur dy javë, gjatë këtyre ditëve të ngrohta korriku çdo ditë kemi ofruar workshope për fëmijë, lojra edukative dhe argetuese, Animacion, Vizita në Komune dhe gjithashtu në fund të programit veror është organizuar një Sfilatë në qytet me veshje Kreative të punuara nga vet fëmijët.



Out door activities, në verore janë zhvilluar edhe në natyrë.



kuader të aktiviteteve lojra



Vizitë në komunën e Klinës, në kuader të aktiviteteve tona verore me fëmijë dhe vullnetar vizituar Komunën e Klinës. Pasi që ishte një ditë Komuna e hapur (Iniciative e OJQ KOHA) për qytetar grupi rinor së bashku më fëmijë vizituan komunën, u mirëpritën fillimisht nga Kryesuesi i Kuvendit z.Fadil



Gashi i cili na mirëpriti në sallën e kuvendit. Dhe pastaj vizituar kryetarin e Komunës z.Zenun Elezaj dhe dy drejtores më të rinjë në komunën e Klinës: Drejtorin për Kulturë Rini dhe Sport- z. Skender Merturi dhe Drejtorin e Inspektoriatit z.Petrit Bekaj.

Të rinjtë ishin shumë kureshtar të takojn personat zyrtar që udhëheqin qeverin lokale dhe të shohin vendin se ku merren vendimet për qytetaret e komunës së Klinës. Shumica prej të rinjve ishin për herë të parë në objektin komunal dhe ishte një kënaqësi të njohin për së afërti me Kryetarin e Komunës dhe drejtoret. Pas kësaj vizite të rinjtë u kthyen në qender rinore për të vazhduar me edukimin jo formal dhe për të reflektuar për viziten e bërë në komunë.



Workshoptet kreative dhe edukuese. Në këto Workshopte fëmijët punuan kostume për djem dhe vajza prej qeseve të plastikes, përveq kostumeve të rinjtë punuan posterin për sfilatë i cili do të jep mesazh të mbrojtjes së mjedisit dhe motivimin e qytetarëve për riciklim të mbeturinave. Ndërsa moshat me të reja punuan vizatime kreative ku në letër shprehen ndjenjat e tyre të argetimit dhe përshkruan sesa ishte i vlefshëm për ata programi veror dhe ndjeshmëria e punës së vullnetarëve. Në përfundim gjithashtu dy fëmijë nga Caritas Umbria zhvilluan kursin e gjuhës italiane dhe i mësuam 30 fëmijë tjerë disa fjalë të gjuhës italiane.



Sfilta 'Riciklo të tanishmen, Ruaje të ardhmen'

Me 23 Korrik 2018 zhvilluam aktivitetin e fundit veror. Programin veror e përfunduam me një sfilatë kreative. Të rinjtë së bashku me 30 fëmijë punuan veshjet kreative nga qeset e plastikes dhe marshuan me një sfilatë ku fëmijët dhanë një mesazh për riciklim të mbeturinave dhe mbrojtje të mjedisit. Programi veror zgjati dy javë në qender rinore dhe gjatë kësaj kohe të rinjtë treguan një angazhim dhe përkushtim të madh në punën rinore dhe punën kreative. Të gjithë reflektuam se sa fëmijët ishin të

kënaqur dhe të lumtur gjatë programit veror 2 javorë, dhe puna jonë ishte e frytshme dhe shumë e suksesshme.



Këtë vit mund të themi se patëm vullnetar shumë aktiv në programin veror dhe të përkushtuar në punë vullnetare.

Falenderojm të gjithë vullnetarët që punuan dhe realizuan programin veror të qendres rinore: Mirilinda Marku, Beatrisa Culaj, Altina Zefi, Artiola Limani, Yllka Gashi, Gresa Gashi, Anita Selitaj, Flamur Berisha, Endrit Morina, Elienta Culaj, Benita G Zogaj, Laureta Duhanaj, Marsela Marku, Aurora Dakaj, Diellza Ferizi.



2.7 Event - Takim rinor, pasi çdo vit antarët e organizatës ndrojnë dhe ndryshimet kalojnë prej nxënësit në student, të rinjtë kanë nevojë të rrin dhe të kalojnë kohë së bashku, të shkëmbejnë përvojat në qendër rinore tek anëtarët e rinjë. Kjo iniciativë është bërë nga vet anëtarët ku kanë zhvilluar temë diskutimi për motivimin e jetës aktive në shoqëri, janë argetuar si dhe kanë përgaditur ushqim të përbashkët. *Punuar me 20 Shtator 2018*





2.8 Halloween n’Klinë 2018

Ngjarja kulturore e festës Halloween e cila tanimë organizohet çdo vit në Klinë nga Qendra Rinore në bashkëpunim me Grupin Rinor “Klina youth Chapter”, me përkrahjen e bizneseve private të Klinës. Janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijë dhe është mundësuar një ambient i mirë ku fëmijët kanë pasur mundësi të luajn dhe të fitojn dhurata dhe shpërblime nga secila lojë. Ngjarja Halloween është realizuar me 31 Tetor duke filluar nga ora 16:00 deri në ora 19:00. Kjo festë ishte një event madheshtor për qytetin e Klinës ku partecipuan rreth 200 fëmijë. Këtë vit pjesëmarrja e fëmijëve ishte në masë të madhe, të shoqëruar me prindër dhe të gjithë fëmijët patën mundësi të vizatojnë fytyrat dhe të marrin pjesë në lojërat me shpërblime. Ky organizim pati ndikim edhe në socializimin në mes të qytetarëve të qytetit të Klinës, pasi që u organizua një ambient familjar. Festa Halloween u përmbyll me një party për të rinjë e cila gjithashtu është organizuar nga anëtarët e Qendres Rinore “Ardhmëria-Klinë.”



2.9 Projekti” Enviromental Education”

Projekti gjashtëmujor i mbështetur nga Balkan Green Foundation (BGF) dhe Instituti për Politikën e Zhvillimit (INDEP) dhe i financuar nga Bashkimi Evropian. Ardhmëria, në pjesën e parë të projektit ka zhvilluar punëtori edukative në dy shkolla fillore dhe qender rinore, aktivitetet e zbatuara në vitin 2018 do të përshkruhen më poshtë:

Në muajin e parë puna është përqendruar në planifikimin e projektit (programi i detajuar), detyrat e administratës dhe takimet me shkollat fillore. Faza e parë e programit është fokusuar në workshopet edukative.

- Në Shkollën Filllore "Ismet Raci" janë zhvilluar 5 workshope me 5 grupe të ndryshme, secila punëtori është udhëhequr nga dy trajner dhe një vullnetar. Punëtoritë filluan me leksione mbi temën e mjedisit dhe problemet kryesore me të cilat ballafaqohet komuniteti ynë çdo ditë, fëmijët ishin shumë të interesuar të mësojnë nga leksionet tona që ne i dhamë dhe gjithashtu kishin mundësi të punonin në grupe të vogla kështu që secila prej tyre kishte për të punuar për mënyrën se si ata mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. Prezantimet e grupeve të vogla ishin shumë kreativ dhe të bukur dhe pas sesioneve ata i vendosën ata në sallën e shkollave në mënyrë që të gjithë të mund të shohin punën e tyre dhe të përmirësojnë edukimin e të rinjve për mjedisin. Nga shkolla "Ismet Raci" kanë përfituar 114 fëmijë (45 femra dhe 69 meshkuj), të moshës 12-13 vjeç.



-Në shkollën fillore Motrat Qiriazhi janë zhvilluar 5 workshope edukative, workshopet filluan me ligjëratat mbi çështjen e mjedisit dhe leksionet e zakonshme u ndoqën me punë krijuese ku secili pjesëmarrës shprehu mënyrën se si ata kuptuan ndikimin e secilit prej tyre në aspektin e rolin që ata kanë në mjedis. Në pjesën e dytë të secilit workshop fëmijët punonin në grupe të vogla (4 ose 5 fëmijë), ishte një mundësi e mirë që në grupe të vogla të lehtësojnë mendimet dhe idetë e tyre se si të rinjtë mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe që është rolin e tyre në komunitetin tonë. Të rinjtë ishin shumë kreativ dhe secili grup i vogël bëri një prezantim të vogël për të gjithë grupin, ishte e mahnitshme të dëgjonin mendimet dhe idetë kreative se si të rinjtë në të ardhmen do të kontribuojnë në komunitet për të mbrojtur mjedisin tonë. Në këtë shkollë idetë e tyre u vendosën në çdo klasë kështu që gjatë mësimëve të ardhshme fëmijët mund të lexojnë dhe ndjekin shembujt e mirë për mbrojtjen e mjedisit. Nga këto workshope morën 112 fëmijë (44 femra dhe 68 meshkuj).



- **Grupi i rregullt** i Qendrës Rinore, grupi i rregullt u formua me thirrje të hapur që ne bëmë në fillim të projektit, ideja për të pasur një grup të rregullt fëmijësh që ata mund të takohen çdo javë në qendrën

e të rinjve. Grupi i 29 fëmijëve të moshës 12-13 vjeç takohen çdo javë dhe ndjekin seminarin edukativ, këto punëtori drejtohen nga të njëjtët trajnerë dhe vullnetarë për të mbështetur dhe edukuar fëmijët se si të përdorin kreativitetin dhe të riciklojnë artikujt që përdorim në shtëpi apo shkollë. Në këto workshope edukative morën pjesë 20-29 fëmijë, prej tyre 17 femra dhe 12 meshkuj. Në pjesën e parë të projektit janë zhvilluar 9 workshope edukative në qender rinore.



Punuar prej 5 tetor-30 Dhjetor 2018

2.10 "16 ditë Aktivizim kunder dhunës ndaj gruas dhe vajzave".

Në kuader të fushatës "16 ditë Aktivizim kunder dhunës ndaj gruas dhe vajzave". Të rinjtë janë përkrahës të Marshit të organizuar nga Grupi Lokal i Grave Aktive në komunën e Klinës.



Punuar me 29 Nëntor 2018.



2.11 Dita Ndërkombëtare e HIV/Aids.

Në ditën ndërkombëtare të Hiv/Aids është organizuar një trajnim një ditor për të rinjtë e moshës 14 -15 vjeç, trajnimi me moton "Vetëdijësohu dhe Ndihmo", me qëllim të vetëdijësimit të të rinjëve për virusin HIV dhe sëmundjen AIDS është udhëhequr dhe ligjeruar nga Peer-Edukatorët vullnetarë në mënyrë që japin kontributin e tyre në zhvillimin dhe edukimin e bashkëmoshatareve të tyre në Klinë.

Punuar me 1 Dhjetor 2018



2.12 Event certifikimi për pjesëmarres të Kursit të gjuhës Italiane. Pas tre muajve punë, përfunduan kursin tre mujor të gjuhës Italiane dhe zhvilluam një ceremoni të vogël mirënjohëse për vullnetarin Italian Umberto Amoroso, u certifikuan 10 të rinjë përfitues të këtij kurs.

Punuar me 18 Dhjetor 2018



2.13 Aktivitetet Humanitare

Bizneset Private: një grup i vullnetareve ka vizitur gati të gjitha bizneset e qytetit të Klinës në mënyrë që të mbledhim fonde për bamirësi, dhe mund të shprehemi se më shumë përkrahje kemi pasur nga bizneset e vogëla sesa nga ato biznese të mëdha.

Punimi i kartolinave: Vullnetaret punuan kartolinat e festave të fundvitit të cilat janë shitur në qendër të qytetit me qëllim për të ngritur fondin për familjet në nevojë. Në punimin e kartolinave Kreative punuan edhe fëmijët që janë pjesë e workshopit edukativ.

Shitja e embëlsirave: të rinjtë organizuan që secili prej tyre të gatujn embëlsira dhe torte në shtëpi dhe ato ti sjellin në grup që së bashku një ditë të ftoftë dimri të shesin.

Nata e filmit: në qendër janë organizuar 3 netë për shfaqje të filmit, në pjesën e paradites janë shfaqur 3 filma për fëmijë ndërsa në mbrëmje tri Nete janë shfaqur Filma për të Rinjë.



Shpërndarja e dhuratave është bërë nga me vullnetarët në udhëhëqje të ekipit punuës të qendres rinore. Janë shpërndarë artikuj ushqimorë dhe veshmbathje duke i ndihmuar 7 familjet në nevojë, në fshatrat e komunës së Klinës. Aktiviteti humanitar është mundësuar nga bashkëpunimi me bizneset e Klinës, qytetaret dhe të rinjtë që kontribuan dhe na ofruan mundësinë që t'a zhvillojmë një aktivitet të tillë humanitar për festat e fundvitit.



Punuar prej 10 -28 Dhjetor 2018.

2.14 Mbrëmje për Krishtlindje dhe Vitin e RI 2019

Christmas party në qender rinore bashkoi grupin e vullnetareve te cilet ishin aktiv gjatë vitit 2018. Kjo mbrëmje festive ishte shumë e hareshme dhe gazmore pasi që festuam një vit me shumë aktivitete të suksesshme. Të rinjtë festuan dhe u argetuan, shkëmbyen dhuratat dhe në fund u ndan mirënjohjet për punën vullnetare.

Faleminderi Rini për vullnetin tuaj. Për shumë Mot Krishtlindja/Merry Christmas



*****Gëzuar Vitin e ri 2019*****



3. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

3.1 Karitas Kosova,

Karitas Kosovo ka marrur një iniciativ për të promovuar platformen e vullnetareve në Kosovë, kemi arritur që të organizojm një grup të vullnetareve në qender rinore për të marrur informata për aplikim dhe regjistrim ne plaformen online për njohjen e punës vullnetare. Maj 2018

3.2 Rock Solid Foundation-Holand

Organizata partnere nga Holanda ka ofruar një seminar ndërkombëtar të financuar nga Erasmus+ me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e projekteve evropiane dhe të zhvillojm partneritete më të forta dhe me të qarta midis pjesëmarrsëve të ndryshem në projektet e shkembimit të vullnetareve, njëkohësisht të mësojm për programin e ri të Erasmus+. Në seminarin 7 ditor moren pjesë 46 pjesëmarrës nga 22 shtete te Evropes qe nga Kosova moren pjesë Vitore Zefi & Venera Bojaj në Amsterdam-Holand. Qershor 2018.

3.3 OPENDATA Kosovo

Organizata ofroi një bashkëpunim për të organizuar një ëorkshop për vajzat e reja të Klinës. Me ofrimin dhe organizimin e njoftimit dhe promovimit të këtij aktiviteti arritem që të kemi një numër të madh pjesëmarrësish në këtë takim. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që t'ju ofrom të rejave të Klinës mundësi për të ngritur kapacitete e tyre në zhvillimin e platformave digitale, Maj 2018.

3.4 Kosovo Center for Security Studies-KCSS

Takim rinor në rajonin e Pejës, me kerkesen për bashkëpunim kemi derguar në trajnimin rajonal një ditor 10 të rinjë në mënyrë që të kontribojn për nevojat dhe prioritet e të rinjve në nivel lokal. Trajnimi wshtw zhvilluar nw qytetin e Pejws, Gusht 2018.